



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:072410

Datë: 31.03.2019

Numri i dokumentit: 00262802

P.nr.28/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN gjyqtari **Sulltan Dobraj**, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër te pandehurit H.H. për shkak te veprës penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-se nga Peja **PP/II.2364/2018 te dt.21.01.2019**, në shqyrtimin fillestar te mbajtur me **dt.04.03.2019**, me pjesëmarrjen e prokurorit te shtetit Lumturije Vuçetaj dhe të pandehurit, po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 15.03.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **H. H.** i lindur me dt... , i biri i B. dhe nënës N. e vajzërisë SH., i identifikuar me nr. personal ..., posedon nr. telefoni ..., shqiptar, shtetas i Kosovës, gjendet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se :

Më dt.22.10.2018 rreth orës 03:20 minuta ... nën ndikimin e alkoolit ka shkelur ligjin për rregullat e trafikut rrugor nga neni 53, ne atë mënyrë që duke qenë nën ndikimin e alkoolit (1.209 promila) drejton veturën e tij te llojit " Mercedes Daimler" ngjyrë e kuqe, më targa, ashtu që më të arritur në vendin e sipërshënuar duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes se automjetit në raport më kufizimin e shpejtësisë më të arritur në kthesë humb kontrollin mbi automjet ku del jashtë rrugës dhe përmbysset në krahë në një kanal, ku si pasojë e këtij vetë aksidenti përveç dëmeve materiale lëndime të lehta trupore kanë pësuar pasagjerët A. J. dhe V. H..

- **me çka ka kryer veprë penale ngasja në gjendje te paaftë apo te dehur nga neni 379 par 2 lidhur me par.1 te KPRK- së.**

Andaj gjykata, ne bazë të nenit 7, 17, 41, 45, 50, 51, 52,58, 59, 73, 74, nenit 379 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-ës, nenit 365,453, 463 të KPPRK-ës, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKQYRJEN NGA SHERBIMI SPROVUES

- I. I shqipton dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej **1(një) vit** të cilin dënim fare **nuk do ta mbaj**, nëse në afat **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
- II. Dënimi me kusht do të mbikëqyret nga shërbimi sprovues.
- III. Gjkata mund ta revokon dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës se verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale.
- IV. **URDHËROHET**, i pandehuri që të mbaj kontaktin me shërbimin sprovues, dhe i njëjti njoftohet se ne rast se i shkëput kontaktet me shërbimin sprovues, gjykata mund të revokoj dënimin më kusht.
- V. **DETYROHET** i pandehuri që të mos konsumoj pije alkoolike dhe i bene me dije se nëse e shkel kete detyrim gjykata do ta revokoj dënimin me kusht.
- VI. Të dëmtuarit A. J. dhe V. H. udhëzohen në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.
- VII. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguan shumën prej 120(njëqindnjëzet) euro ndërsa për shpenzime të procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë nëse gjënë shpenzime të tilla.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë me aktakuzën **PP/II.2364/2018 te dt.21.01.2019**, ka akuzuar të pandehurin H. H., për shkak të veprës penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtit, të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjkata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt. **dt.04.03.2019**, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit të aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, të cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar më aktvendim në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor në bazë të nenit 248 të KPRK-ës.

Prokurorja në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë e ky pranim fajësie mbështetet me provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lendes unë ne tersi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik te saj, gjykatës i propozoi që i njëjti te shpallet fajtor dhe ta dënon ne bazë te ligjit, lidhur me vendimin për dënim si rrethana lehtësuese te merr pranimin e fajësisë.

I pandehuri ne fjalën përfundimtare deklaroi se : shprehi keqardhje, jam shumë i penduar, premtoi që në të ardhmen do te jem i kujdesshëm.

Gjykata me pranimin e fajësisë në tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: më dt.22.10.2018 rreth orës 03:20 minuta nën ndikimin e alkoolit ka shkelur ligjin për rregullat e trafikut rrugor nga neni 53, ne atë mënyrë që duke qenë nën ndikimin e alkoolit (1.209 promila) drejton veturën e tij te llojit " Mercedes Daimler " ngjyrë e kuqe, me targa..., ashtu që me te arritur në vendin e sipërshënuar duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes se automjetit në raport me kufizimin e shpejtësisë me te arritur ne kthesë humb kontrollin mbi automjet ku del jashtë rrugës dhe përmbysset ne krahë në një kanal, ku si pasojë e këtij vetë aksidenti përveç dëmeve materiale lëndime te lehta trupore kanë pësuar pasagjerët A. J. dhe V. H..

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë dhe i ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do te shpallet fajtor për veprën penale te lartcekur, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do te këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë, dhe ne mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barre, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht ne kuptim te nenit 257 te KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë konform nenit 248 te KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur ne përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës se veprës penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-së, ka konstatuar se i pandehuri nuk ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra, nuk i ka dashur ato veprime dhe pasojën e shkaktuar nuk e ka dëshiruar, për veprimet e tilla te cilat përmbushen elementet e veprës penale të lartcekur është përgjegjës dhe i përgjegjshëm, për veprën penale, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për veprën penale, pastaj i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar më burgim si në dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe ka urdhëruar që dënimi më kusht të mbikëqyret nga shërbimi sprovues.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje më shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit, shkallen e rrezikshmërisë shoqërore, dhe ne

këtë mënyrë do te ndikoj ne arritjen e qëllimit të dënimit që parashihet në nenin 41 te KPRK-ës, si masë për parandalimin e të pandehurit por edhe si masë për parandalimin e të pandehurve dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Më rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, të cilat mund te ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurit. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljet e mira gjatë gjykimit, pendimi i tij , i pa dënuar me parë ndërsa si rrethanë renduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Në bazë të nenit 58 gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënimin më kusht dhe ka urdhëruar që dënimi më kusht të mbikëqyret nga shërbimi sprovues, sepse ka konsideruar se integrimi i të dënuarve në shoqëri do te arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues, dhe i ka bërë më dije të pandehurit se është i obliguar të mbaje kontaktet më shërbimin sprovues, duke e njoftuar se në rast se i shkëput kontaktet më shërbimin sprovues gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

Gjykata ne baze te nenit 59 paragraf 1 nën paragraf 1.8 te KPK i ka përcaktuar detyrimin qe te heq dorë nga konsumimi i pijeve alkoolike dhe i ka bere me dije se nëse e shkel kete detyrim gjykata do ta revokoj dënimin me kusht.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPPK-së të dëmtuarit A. J. dhe V. H. i ka udhëzuar në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Në bazë të nenit 453 te KPPK-së gjykata të pandehurin e ka obliguar që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguan shumën prej 120 (njëqindnjëzet) euro duke llogaritur këtu shpenzimet prej 20 euro për ekspertizën mjeko ligjore, shumen prej 50 euro ekspertizën e komunikacionit, dhe paushallin gjyqësor në shume prej 20 euro si dhe shumen prej 30 euro ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.28/2019 të dt.15.03.2019**

**Sekretarja juridike
Sabiha Hoxha**

**G J Y Q T A R I
Sulltan Dobraj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore Pejë dega ne Deçan.